





- 1) Në një depo janë vendosur 120 kuti kubike në formën e një kuboidi me dimensione $6 * 5 * 4$. Të gjitha kutitë që kanë kontakt me ajrin nga të paktën një faqe ose me dyshe-menë, dëmtohen. Sa kuti mbeten të padëmtuara?
- A) 6 B) 24 C) 12 D) 30
- 2) Në figurë paraqitet shpërthimi aksonometrik (exploded axonometric) i një trupi solid gjeometrik. Cili nga trupat e dhënë i korrespondon?




A) 1



B) 4







C) 2



D) 3

- 3) Cili nga piktorët e mëposhtëm nuk është përfaqësues i ekspresionizmit?
- A) Edvard Munch B) Wassily Kandinsky
C) Egon Schiele D) Leonardo Da Vinci

- 4) Në ushtrimin e mëposhtëm, zgjidhni figurën/diagramin që paraqet saktë marrëdhënien ndërmjet bashkësive të termave të dhënë: Italian; Shqiptar; Punëtor;



- 5) Lexoni të dhënat e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjes. Aldo, Bledi, Ceni, Dori, Elio, Flora dhe Greta janë shtatë fëmijë. Moshja e secilit është një numër i plotë dhe moshat e tyre janë shtatë numra njëpasnjëshëm, të vendosur diku midis 1 dhe 10 vjeç. Jepen këto informacione: Dori është 3 vjet më i vogël se Aldo. Bledi ka moshën e mesme të grupit. Aldo është 2 vjet më i madh se Bledi. Flora është më e vogël se Bledi me po aq vite sa Ceni është më i madh se Dori. Greta është më e madhe se Flora. Sa vjet më i e madhe është Greta se Flora?

- A) 5 B) 3 C) 2 D) 4

- 6) Gjeni numrin që mungon.


3	5	16
4	2	?
1	4	10

- A) 12 B) 18 C) 14 D) 16

- 7) Cili nga çiftet vepër - autor është i saktë?

- A) “I huaji” - Gabriel García Márquez B) “Plaku dhe Deti” - Ernest Hemingway
C) “Njëqind vjet vetmi” - Jorge Luis Borges D) “Procesi” - Albert Kamy

8) Cilat prej paraqitjeve me projeksione, korrespondojnë me trupin e dhënë në aksonometri ?



9) ADN-ja ndodhet kryesisht në:

- A) Bërthamë
- B) Mitokondri
- C) Aparatin e Golxhit
- D) Ribosome


10) Në një bllok banimi: $\frac{7}{8}$ e banorëve të këtij blloku banimi kanë makinë. $\frac{2}{3}$ e tyre kanë biçikletë. Sa është pjesa minimale e banorëve që kanë edhe makinë edhe biçikletë?

- A) $\frac{1}{2}$ e banorëve kanë edhe makinë edhe biçikletë.
- B) $\frac{7}{12}$ e banorëve kanë edhe makinë edhe biçikletë.
- C) $\frac{13}{24}$ e banorëve kanë edhe makinë edhe biçikletë.
- D) $\frac{2}{3}$ e banorëve kanë edhe makinë edhe biçikletë.

11) Rryma e mendimit të Iluminizmit vlerësonte:

- A) Pushtetin absolut.
- B) Filozofinë e luftës dhe zgjerimin ushtarak.
- C) Filozofinë e ligjit të natyrës dhe të së drejtës së njeriut.
- D) Privilegjet feudale.

12) Në figurë paraqitet plani i prerë me tre rrafshë. Cila nga alternativat e dhëna korrespondon me prerjet e sakta të tij?



13) Gjeni alternativën e saktë.

- A) Shqipëria u anëtarësua në NATO më 8 dhjetor 1990.
- B) Kongresi i Manastirit u zhvillua më 8 dhjetor 1912.
- C) Pavarësia e Shqipërisë u shpall më 8 dhjetor 1920.
- D) Lëvizja studentore për lejimin e pluralizmit politik në Shqipëri filloi më 8 dhjetor 1990

14) Cili zhvillim karakterizoi fazën e parë të Revolucionit Industrial?

- A) Mekanizimi i industrisë tekstile dhe përdorimi i makinës me avull.
- B) Automatizimi elektronik dhe përdorimi i teknologjisë digjitale.
- C) Përdorimi i energjisë elektrike dhe prodhimi masiv i automobilave.
- D) Zhvillimi i industrisë kimike dhe përdorimi i motorit me djegie të brendshme.


15) Grupi i gjakut universal dhurues është:

- A) O-
- B) A+
- C) AB+
- D) B+



16) Një qelizë ndahet në dy qeliza të reja gjatë një intervali kohe t . Pas një kohe $5t$, duke u nisur nga një qelizë e vetme, qelizat e prodhuara janë:

- A) 16
- B) 63
- C) 32
- D) 10

- 17) Është dhënë aksonometria e vijës së thyer ABC. Cili nga projeksionet në planet e projekimit tregon madhësinë reale të segmentit të tij?




- A) Projektioni ab. B) Projektioni bc. C) Projektioni a'b'. D) Projektioni b'c'.
- 18) Arta, Bledi, Ceni dhe Dori kanë së bashku 204 lapsa. Dori ka tre herë më shumë lapsa se Ceni, ndërsa Arta ka 8 lapsa më shumë se Ceni. Ceni ka gjysmën e lapsave të Bledit. Sa lapsa ka Arta?
- A) 32 B) 44 C) 40 D) 20
- 19) Një djalë qëndron në një luginë midis dy shkëmbinjve të lartë e vertikalë (A dhe B). Ai ndodhet më afër shkëmbit A se sa shkëmbit B. Në një moment, ai përplas duart fort. Tingullin e parë e dëgjon pas 4 sekondave dhe të dytin e dëgjon pas 6 sekondave. Sa është distanca mes dy shkëmbinjve, duke ditur shpejtësinë e zërit në ajër $v = 340 \text{ m/s}$?
- A) 525m B) 3400m C) 1250m D) 1700m
- 20) Në figurë paraqitet plani i një relievi i parë nga lart. Cila nga alternativat e dhëna paraqet prerjen tërthore A-A të saktë të tij?



- A) 3 B) 4 C) 2 D) 1

- 21) Dua të ndërtoj një 'piramidë' me 3 nivele me gurë në formë kubash, si në figurën më poshtë: në nivelin më të lartë ka vetëm 1 kub, një nivel më poshtë ka 5, e në këtë mënyrë vazhdon. Sa kuba duhet të vendos gjithsej?



- A) 19 B) 18 C) 16 D) 20



- 22) Në cilat mënyra u zgjeruan kryesisht principatat arbërore gjatë Mesjetës?

- A) Nëpërmjet tregtisë dhe pelegrinazheve.
B) Nëpërmjet zgjedhjeve dhe referendumeve.
C) Nëpërmjet lidhjeve martesore dhe luftërave.
D) Nëpërmjet kolonizimit dhe veprimtarisë misionare.


- 23) Cili çift paraqet lidhjen e saktë ndërmjet objektit dhe tipologjisë arkitektonike?

- A) Koloseu — amfiteatër B) Partenoni — bazilikë
C) Akropoli — hipodrom D) Forumi — teatër


- 24) Në figurë paraqiten projeksionet e disa trupave gjeometrikë. Cila nga alternativat e dhëna paraqet pamjen aksonometrike të saktë të tyre ?




A) 4



B) 3



C) 1



D) 2


25) Cili krahasim paraqet saktë dallimin politik ndërmjet Athinës dhe Spartës?

- A) Të dyja kishin të njëjtin sistem demokratik.
- B) Athina ishte demokratike, ndërsa Sparta oligarkike.
- C) Athina ishte oligarkike, ndërsa Sparta demokratike.
- D) Të dyja qytet-shtetet drejtoheshin nga perandorë.

26) Gjeni alternativën e gabuar. Kristofor Kolombi:

- A) Arriti në Amerikë në vitin 1492.
- B) Arriti në Amerikë në vitin 1482.
- C) Udhëtimi i tij hapi një fazë të re të zbulimeve evropiane në Botën e Re.
- D) Udhëtoi drejt perëndimit duke kërkuar një rrugë për në Azi.

27) Në figurë paraqitet trupi gjeometrik në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna paraqet projeksionet e sakta të tij?



28) Në sekuencën e mëposhtme numri X është:

2	(6)	20
4	(10)	34
6	(14)	48
7	(X)	52

- A) X= 16 B) X= 17 C) X= 18 D) X= 15

29) Cili nga shoqërimet e mëposhtme mes veprës dhe autorit nuk është i saktë?

- A) “Britma” - Claude Monet B) “Mona Lisa” - Leonardo da Vinci
- C) “Dasma Shkodrane” - Kolë Idromeno D) “Guernica” - Pablo Picasso


30) Rilindja Evropiane lindi fillimisht në:

- A) Itali B) Angli C) Greqi D) Francë

31) Kostandinopoja ishte një qendër e madhe gjatë:

- A) Iluminizmit
- B) Periudhës bizantine
- C) Revolucionit Industrial
- D) Periudhës bashkëkohore

32) Në planimetrinë e paraqitur, në cilën hapësirë (secila e treguar me një numër) ndodhet hyrja për në apartament?



- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 6

33) Shqipëria kufizohet me:

- A) 4 shtete
- B) 3 shtete
- C) 6 shtete
- D) 5 shtete

34) Për të ndërtuar një mur, 9 punëtorë duhet të punojnë 2 orë. Pas 1 ore pune, 3 punëtorë largohen për të ndërtuar një mur tjetër. Sa kohë duhet të punojnë punëtorët e mbetur për ta përfunduar murin?

- A) 2 orë
- B) 30 minuta
- C) 1 orë
- D) 1 orë e 30 min

35) Muri i Berlinit ndante:

- A) Sektorin amerikan nga sektorët britanik dhe francez të Berlinit.
- B) Berlinin Perëndimor nga Republika Federale Gjermane.
- C) Berlinin Lindor nga Berlini Perëndimor.
- D) Berlinin Lindor nga pjesa tjetër e Gjermanisë Lindore.


36) Cili shtet filloi pushtimin ushtarak të Shqipërisë më 7 prill 1939?

- A) Italia fashiste
- B) Greqia
- C) Gjermania naziste
- D) Jugosllavia

37) Dy motra po hanin kumbulla nga një tas. Motra e parë hëngri $\frac{1}{3}$ e të gjitha kumbullave. Më pas, motra e dytë hëngri $\frac{1}{3}$ e kumbullave që kishin mbetur. Pas kësaj, në tas mbetën 8 kumbulla. Sa kumbulla kishte fillimisht në tas?

- A) 22
- B) 18
- C) 16
- D) 24

38) Ndërmjet 4 figurave të mëposhtme, tregoni se cilat mund të rotullohen e kombinohen në mënyrë që të formojnë figurën në krah.



A) Figura 1 dhe 2

B) Figura 2 dhe 4

C) Nuk është e mundur

D) Figura 3 dhe 4

39) Katrori i dhënë përfaqëson projektionin në planin horizontal të trupave:



1.kub, kuboid, cilindër.

2.kuboid, cilindër.

3.kub, kuboid.

4.kub, cilindër.


A) 3

B) 2

C) 1

D) 4

40) Gjeni figurën që mungon.



41) PBB është shkurtim për:

- A) Prodhimi i Brendshëm Bruto
- C) Plani Buxhetor Botëror

- B) Prodhimi Bazë Bruto
- D) Produkti Bazë Bankar

42) Humanizmi ishte një rrymë intelektuale që:

- A) Bazohej në mohimin e trashëgimisë klasike.
- B) Mbronte rendin feudal.
- C) Kundërshtonte arsimin laik.
- D) Bazohej mbi vlerën dhe dinjitetin njerëzor.

43) Cili ishte synimi politik i programit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit?

- A) Vendosja e trojeve shqiptare nën administrimin austro-hungarez.
- B) Ruajtja e vilajeteve shqiptare si njësi të veçuara.
- C) Bashkimi i trojeve shqiptare në një vilajet administrativ autonom.
- D) Ndarja e trojeve shqiptare ndërmjet shteteve ballkanike.


44) Cilën bazilikë rindërtoi Donato Bramante, bazuar në stilin bizantin të kupolës?

- A) Kishën e Shën Sofisë
- B) Bazilikën e Shën Pjetrit
- C) Bazilikën e Linit
- D) Bazilikën e Shën Vitalit


45) Tregoni cili numër vazhdon vargun: 3, 8, 18, 38, 78, 158, ...

- A) 308
- B) 328
- C) 318
- D) 298

- 46) Janë dhënë formatet A0, A1, A2, A3, A4, A5. Zgjidhni raportin korrekt të përmasave ndërmjet tyre.



- 47) Dori gjeti një ushtrim enigmatik me skemë trekëndore ku secili numër në rreshtin e poshtëm formohej nga shuma e dy numrave që kishte më sipër, saktësisht si në figurën më poshtë, majtas. Skema e ushtrimit të Dorit ishte prishur dhe kishin ngelur vetëm 4 numra të lexueshëm si në figurën më poshtë djathtas. Gjeni cili numër qëndron në vendin e pikëpyetjes “?”.



- A) 27 B) 18 C) 19 D) 12

- 48) Ardi është më i shpejtë se Bledi; Bledi është më i ngadaltë se Klajdi; Klajdi është më i shpejti nga të tre. Në bazë të këtyre të dhënave, cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?

- A) Ardi është më i ngadalti nga të tre. B) Ardi është më i shpejtë se Klajdi.
C) Klajdi është më i shpejtë se Ardi. D) Bledi është më i shpejti nga të tre.

- 49) Në një fletë projekti, një dhomë drejtkëndore i ka brinjët 3cm dhe 5cm. Projekti fotokopjohet me një zmadhim të tillë që sipërfaqet rezultojnë 144%. Dimensionet e dhomës në fotokopje janë:

- A) 4 cm dhe 6,4 cm B) 50 mm dhe 71 mm
C) 4,3 cm dhe 7,2 cm D) 3,6 cm dhe 6 cm

- 50) Cili shtet ka sipërfaqen më të madhe?

- A) Kanadaja B) SHBA C) Rusia D) Kina

- 51) Selia e NATO-s ndodhet në:

- A) Londër B) Berlin C) Paris D) Bruksel

- 52) Cila është temperatura e ujit që përftohet duke përzier 1 litër ujë në temperaturën 0°C me 0,5 litër ujë në temperaturën 60°C?

- A) 10°C B) 30°C C) 20°C D) 40°C

53) Sa numra të ndryshëm 4-shifrorë mund të formohen nga shifrat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 pa përsëritje, në mënyrë që të fillojnë me 1?


A) 120

B) 180

C) 40

D) 60

54) Sa faqe ka trupi gjeometrik i paraqitur me dy projeksione?










A) 5 faqe

B) 8 faqe

C) 6 faqe

D) 7 faqe

55) Lidhni boshtet me paraqitjen aksonometrike përkatëse të cilindrit.




A) 2C, 1A, 4D, 3B

B) 1B, 2D, 3C, 4A


C) 4A, 3B, 1C, 2D

D) 2D, 4B, 3A, 2C

56) Lidhni paraqitjen perspektive të saktë me paraqitjet grafike të dhëna:



57) Hija e hedhur e segmentit tregon që ai:




- A) është më afër me planin horizontal.
C) është i baraslarguar nga të dy planet.

- B) është i cfarëdoshëm.
D) është më afër me planin vertikal.

58) Cila koloni helene në bregdetin ilir u themelua rreth vitit 627 p.e.s. nga korintasit dhe korkyrasit?

- A) Fari B) Dyrrahu C) Isa D) Oriku

59) Cila është pika e mesit të segmentit nga A tek B?



A) pika 2

B) pika 3

C) pika 1

D) pika 4

60) Cilin qytet zgjodhi si kryeqytet të përkohshëm qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës, e kryesuar nga Sulejman Delvina?

A) Durrësin

B) Vlorën

C) Tiranën

D) Lushnjën

Answer Key

Testname: UNTITLED1

- 1) B
- 2) A
- 3) D
- 4) D
- 5) A
- 6) A
- 7) B
- 8) A
- 9) A
- 10) C
- 11) C
- 12) B
- 13) D
- 14) A
- 15) A
- 16) C
- 17) A
- 18) A
- 19) D
- 20) C
- 21) A
- 22) C
- 23) A
- 24) C
- 25) B
- 26) B
- 27) A
- 28) D
- 29) A
- 30) A
- 31) B
- 32) C
- 33) A
- 34) D
- 35) C
- 36) A
- 37) B
- 38) B
- 39) C
- 40) C
- 41) A
- 42) D
- 43) C
- 44) B
- 45) C
- 46) A
- 47) B
- 48) C
- 49) D
- 50) C
- 51) D
- 52) C
- 53) D
- 54) A

Answer Key

Testname: UNTITLED1

55) C

56) C

57) A

58) B

59) D

60) C